



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 59 paragrafi 4.1, 63, nenin 64 paragrafi 2.1 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenin 41 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përmes votimit në procedurë qarkulluese, me datë 01.08.2024, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Miratimin e Projektit “Informimi dhe Edukimi i Votuesve Jashtë Kosovës për Ndryshimet dhe Mundësitë e Reja për Regjistrim dhe Votim”

- I. Miratohet Projektit “Informimi dhe Edukimi i Votuesve Jashtë Kosovës për Ndryshimet dhe Mundësitë e Reja për Regjistrim dhe Votim”.
- II. Projekti si në pikën I është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- III. Obligohet Sekretariati për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 01.08.2024

Kryesues

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve


Kreshnik Radoniqi



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

PËRMBLEDHJE E PROJEKTIT	
Titulli i Projektit:	Informimi dhe Edukimi i Votuesve Jashtë Kosovës për ndryshimet dhe mundësitë e reja për regjistrim dhe votim
Qëllimi i përgjithshëm	Qëllimi i këtij projekti është të informojë votuesit jashtë Kosovës për mundësitë e reja dhe lehtësimin e procedurave për regjistrim dhe votim jashtë Kosovës.
Periudha e realizimit	Gusht - shtator 2024
Udhëheqës i Projektit	Divizioni për Edukim dhe Informim
Kostoja financiare	3,000€

Prishtinë Korrik 2024

1. Hyrja

KQZ-ja do t'i informoi bashkatdhetarët për ndryshimin dhe lehtësimin e procedurave të votimit nga jashtë Kosovës. Këto ndryshime përfshijnë procedurat e reja të regjistrimit për votim jashtë vendit, përmirësimet në procesin e votimit, dhe mundësitë e reja për votimin në përfaqësitë diplomatike. Ky projekt synon të rrisë informimin për të gjithë votuesit kosovarë që jetojnë jashtë vendit dhe të jenë të informuar për të drejtat dhe mundësitë e tyre për votim.

2. Qëllimi

Qëllimi i këtij projekti është të informojë votuesit jashtë Kosovës për mundësitë e reja dhe lehtësimin e procedurave për regjistrim dhe votim jashtë Kosovës.

Regjistrimi për votuesit jashtë Kosovës për votim, mund të bëhet përmes:

- Platformës elektronike të aplikimit për regjistrim të votuesve jashtë Kosovës; ose
- Postës, në kutinë postare të KQZ.

Shtetasit gjatë aplikimit për regjistrim do të kenë mundësi të zgjedhin, njëren nga mënyrat e votimit, si në vijim:

- Të votoj fizikisht, në përfaqësi diplomatike të Republikës së Kosovës, vetëm për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës;
- Duke dërguar fletëvotimet përmes postës në kutinë postare në Kosovë;
- Duke dërguar fletëvotimet përmes postës në një nga kutitë postare jashtë Kosovës, të hapura nga KQZ.

Gjithashtu votuesit do të informohen edhe për mënyrën e votimit.

3. Objektivat e Projektit:

1. Informimi i votuesve jashtë Kosovës për mundësitë e reja për regjistrim dhe votim;
2. Rritja e pjesëmarrjes së votuesve jashtë Kosovës në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës.

4. Aktivitetet

Aktiviteti 1: Fushatë informuese në mjtetet e komunikimit të KQZ-së (online)

Përgatitja e materialeve:

- Realizimi i videospoteve për informimin e votuesve jashtë Kosovës, për mundësitë e reja për regjistrim dhe votim.
- Përgatitja e përmbajtjes dhe dizajnit të fletëpalosjes që përmbanë informacione të rëndësishme, për mundësitë e reja për regjistrim dhe votim jashtë Kosovës.
- Dizajnimi i posterit që përmbanë mesazhe kryesore për votuesit jashtë Kosovës, për mundësitë e reja për regjistrim dhe votim.

Publikimi dhe shpërndarja, në:

- Webfaqen dhe rrjetet sociale të KQZ-së.
- Dërgimi i informacioneve për votuesit jashtë Kosovës, përmes e-maileve që KQZ i posedon nga proceset zgjedhore të kaluara.

Aktiviteti 2: Fushatë informuese në Televizione dhe Radio Nacionale

Përgatitja e materialeve:

Realizimi i radiospoteve për informimin e votuesve jashtë Kosovës, për mundësitë e reja për regjistrim dhe votim dhe Videospotet e realizuara në aktivitetin nr. 1, do të transmetohen në:

- RTK1, RTK2, RT3, dhe
- Radio Kosova 1 dhe Radio Kosova 2.

Aktiviteti 3: Fushatë informuese në hapësirat e Aeroportit “Adem Jashari” në Prishtinë

Përgatitja e materialeve:

- Editimi i videospoteve (të realizuar në aktivitetin e parë) deri në 15 sekonda, për informimin e votuesve jashtë Kosovës, për mundësitë e reja për regjistrim dhe votim.

Publikimi i videospoteve në:

- Së paku katër Ekrane reklamimi, që do të shfaqën kohë pas kohe.

Shpërndarja e fletëpalosjeve dhe lapsë kimikëve, në:

- Tavolinën ndihmëse për informacion;
- Pesëmbdhjetë (15) shtande (të OE që operojnë në Aeroport) të vendosura në hapësirat më të frekuentuara; dhe
- Zonën e pritjesë.

Aktiviteti 4: Fushatë informuese në pikëkalimet kufitare toksore

- Shpërndarja e fletëpalosjeve që përmbajnë informacione të rëndësishme, për mundësit e reja për regjistrim dhe votim jashtë Kosovës (e njëjta fletëpalosje si në aktivitetin nr. 1).
- Shpërndarja e lapsë kimikëve.

Aktiviteti 5: Bashkëpunimi me institucionet dhe Organizatat e Shoqërisë Civile¹

Shpërndarja dhe publikimi i materialeve do të bëhet, në:

- Webfaqet dhe rrjetet sociale të komunave;
- Webfaqet dhe rrjetet sociale të përfaqësive diplomatike;
- Rrjetet sociale të organizatave të shoqërisë civile; dhe
- Portale.

¹ OSHC, Germin, KDI, D4D, Democracy Plus, YIHR, INPO, VoRAE, Ngo Aktiv, Rrjetit të grave të Kosovës, etj. Ndërsa në portale ne i dërgojm materialet te të gjitha portalet, mandej mbetet në vullnetin e tyre nëse i publikojnë (zakonisht i publikojnë).

3. Sloganet e propozuarar

Propozimet për sloganin e mundshëm janë dhënë si në vijim, ndërsa mbetet që KOZ-i të përcaktohet për njërin prej tyre, apo ndonjë propozim tjetër nga ana e tyre.

"Mërgata voton!" Logoja e KQZ-së

Slogani i përzgjedhur do të vendoset në të gjitha materialet e realizuarar.

4. Përfundimi

Ky projekt do të ndihmojë që votuesit kosovarë jashtë vendit të jenë të informuar dhe të gatshëm për të marrë pjesë në zgjedhje, në përputhje me ndryshimet e reja ligjore. Përmes kësaj fushate informuese, synojmë të arrijmë një pjesëmarrje më të lartë dhe një proces të suksesshëm votimi për të gjithë qytetarët e Kosovës që jetojnë jashtë vendit. Ketë do ta realizojmë përmes mjeteve të ndryshme të komunikimit dhe bashkëpunimit me institucionet dhe OSHC-të.

5. Plani për realizimin e aktiviteteve të projektit

Në tabelën në vijim janë të përshkruara aktivitetet dhe afatet kohore për realizimin e projektit.

Tabela nr.1. Afatet kohore për realizimin e projektit.

Nr.	Aktivitetet	Kohëzgjatja	Përgjegjësit
1.	Shqyrtimi dhe miratimi i projektit	1 gusht 2024	Këshilli për Operacione Zgjedhore Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
2.	Përgatitja e specifikave	1 gusht 2024	Divizioni për Informim dhe Edukim të Votuesve
3.	Procedurat tenderuese.	2 - 8 gusht 2024	Zyra e prokurimit
4.	Përgatitja e përmbajtjes së produkteve	2 gusht 2024	Divizioni për Informim dhe Edukim të Votuesve dhe Zëdhënësi
5.	Shqyrtimi dhe miratimi i përmbajtjes së produkteve	2 gusht 2024	Këshilli për Operacione Zgjedhore
6.	Dizajni i fletëpalosjes dhe posterit.	9 gusht 2024	Këshilli për Operacione Zgjedhore
7.	Përgatitja e videospoteve,	9 - 10 gusht 2024	Divizioni për Edukim dh Informim Operatori Ekonomik
8.	Shqyrtimi dhe miratimi i videospotit, fletëpalosjes dhe posterit	10 gusht 2024	Këshilli për Operacione Zgjedhore
9.	Sigurimi i laps kimikëve	6 gusht 2024	Menaxheri i kontratës
10.	Përgatitja e media planeve për transmetim, publikim dhe sponsorizim	5 - 7 gusht 2024	Divizioni për Edukim dh Informim Operatori Ekonomik
11.	Shpërndarja e materialeve në Aeroportin "Adem Jashari" Prishtinë	9 gusht 2024	Divizioni për Edukim dh Informim Divizioni për Administratë dhe Shërbime të përbashkëta
12.	Shpërndarja e fletëpalosjeve dhe laps kimikëve në pikëkalimet kufitare	11 - 13 gusht 2024	Divizioni për Administratë dhe Shërbime të përbashkëta dhe ZEKZ-të
13.	Dërgimi i informacioneve votuesve jashtë Kosovës, përmes e-mailave	12 - 13 gusht 2024	Divizioni për Shërbim të Votuesve Divizioni për Edukim dh Informim
14.	Shpërndarja e materialeve për publikim dhe transmetim	14 gusht 2024	Divizioni për Edukim dh Informim
15.	Përgatitjen e raportit	15 - 30 shtator 2024	Divizioni për Informim dhe Edukim të Votuesve

6. Planifikimi financiar për realizimin e projektit

Në tabelën në vijim janë specifikuar produktet, shërbimet dhe sasi të për realizimin e projektit.

Tabela 2. Produktet, shërbimet dhe kostoja financiare

Nr.	Produktet/shërbimet	Përshkrimi	Sasia	Çmimi për njësi	Totali
1.	Produksioni i videoanimacionit. Editimi i videove me informatat kryesore	Një Videoanimacion/grafika, përfshirë të gjitha aktivitetet e produksionit: melodinë (të cilin e posedon e KQZ-ja), përcjelljet me zë, gjuha me shenja etj. (i njëjti duhet të realizohet me titra në gjuhën serbe dhe turke). Adaptimi për rrjetet sociale.	1	200	200
2.	Dizajnimi i posterit për rrjetet sociale	Dizajni i posterit dhe adaptimi për rrjetet sociale (në gjuhën shqipe, serbe, dhe turke).	1	39	39
3.	Produksioni i Radiospoteve	Përfshirë të gjitha aktivitetet e produksionit: melodinë (të cilin e posedon e KQZ-ja). (në gjuhën shqipe, serbe dhe turke).	3	30	90
4.	Fletëpalosje, dizajnin dhe printimin. Përkthimin dhe lektorimin në gjuhën turke. Ndarja dhe paketimi i fletëpalosjeve do të bëhet nga OE për pikëkalimet kufitare, sipas listës së ofruar nga KQZ. Pas printimit do të sjellën në depon e KQZ - së.	Dizajni dhe printimi, dimensionet Letër 135 gsm (Glossy, Mat) A4/ dy thyerje (99mm) Color Print Offset. (Një lloj, printimi në gjuhën shqipe, serbe, dhe turke).	8,000	0.04	320€
5.	Rrjete sociale (Facebook, Twitter, Instagram, Youtube, LinkedIn)	Publikimi i posterit dhe i videove dhe sponsorizimi i tyre, në Facebook, Twitter, Instagram in, ads 150,000K Lokacioni: brenda dhe jashtë vendit. •Gjinia: Të gjitha •Moshë: 18+,			250€

		Kohëzgjatja: 30 ditë (njësia e pagesës me ditë).			
7.	<p>Kimikë.</p> <p>Ndarja dhe paketimi do të bëhet nga OE për 38 komuna sipas listës së ofruar nga KQZ.</p> <p>Pastaj do të sjellën në depon e KQZ - së.</p> <p>Kimikët do të sigurohen nga kontrata ekzistuese nga AQP.</p>	<p>Kimikë Rollerballs 0.7mm.</p> <p>Të ngjyrave: të bardha dhe të kaltërta.</p> <p>Dizajni i sloganit të përcaktuar nga KQZ, i cili do të shtypet mbi kimikë.</p> <p>(Slogani mbi kimikë duhet të shtypet në gjuhën shqipe, serbe, dhe turke).</p>	8.000	0.25	2,000€
Paramasa e përafërt					2,900€

Buxheti nuk është planifikuar por duhet të sigurohet.